

996/997 9 – NUMRI PËR HUAZIM

Tek huazimi i monografive apo serialeve nënfusha 996/9979 mund të përdoret si alternativë për numrin e inventarit. Kryesisht përdoret për shënimin e numrave të shtypur në barkod, nëse ndryshojnë nga numri i inventarit. Numri nga barkodi mund të vendoset në mënyrë automatike përmes lexuesit të barkodeve, mirëpo mund të shënohet edhe në mënyrë manuale.

Numri për huazim është i indeksuar në indeksin shtesë CN=". Numrat për huazim në bazën e të dhënave nuk duhet të mbulohen me numrat e inventarit.

Gjatësia e nënfushës 996/9979 mund të jetë e njëjtë, më e madhe ose më e vogël se madhësia e nënfushës 996/997f – *Numri identifikues i botimit – Numri i inventarit*. Mbulimi me numrat e inventarit duhet shmangur nëse gjatësia e nënfushës 996/9979 është ndryshe nga gjatësia e nënfushës 996/997f. Nëse gjatësia e nënfushave është e njëjtë, shenja e parë në nënfushë duhet të tregojë nëse është numër inventari apo numër për huazim.

Çdo fushë 996/997, në bazë të së cilës huazohet materiali, duhet të ketë të plotësuar nënfushën 996/997f, ndërsa nënfusha 996/9979 nuk është e detyrueshme. Në këtë mënyrë mundësohet kombinimi i huazimit brenda institucionit, sepse materiali mund të huazohet me ndihmën e numrit të inventarit ose me ndihmën e numrit për huazim.

Tek **monografitë** nënfusha 9969 nuk është e përsëritshme (shih shembullin 1).

Tek **serialet** nënfusha 9979 është e përsëritshme. Shënimi i të dhënave në nënfushë varet nga vlera e treguesit 1 – treguesi i lidhjes:

- Treguesi 1 = "0" (numra të palidhur)
Struktura e shënimit të të dhënave është kjo: **numri_për_huazim#numri_i_vëllimit**
Çdo numër i vëllimit mund të ketë numrin për huazim, mirëpo nuk është e domosdoshme (shih shembullin 2).
- Treguesi 1 = "1" (numra të lidhur dhe të palidhur)
Struktura e shënimit të të dhënave është kjo: **numri_për_huazim#numrat_e_vëllimeve_të_lidhura**
(shih shembullin 3).
- Treguesi 1 = "2" (numra të lidhur)
Shënimi i të dhënave në nënfushë është i njëjtë sikurse tek monografitë (shih shembullin 4).

Nëse biblioteka ka pasur numra të palidhur, ndërsa më vonë i ka lidhur ata në një komplet, vlera e treguesit 1 duhet të jetë "2" dhe në nënfushën 997m të gjitha shenjat "+" të zëvendësohen me shenjën "_". Duhet të fshihen të gjitha nënfushat 9979 të përcaktuara më parë për secilin vëllim dhe kompletit t'i shtohet vetëm një numër shtesë për huazim. Ky numër mund të jetë i ri ose njëri nga numrat e ndonjërit nga vëllimet e palidhura. Struktura e nënfushës 9979 mbetet e njëjtë sikurse tek monografitë – pa shenjën për ndarje "#" dhe pa numrin e vëllimit (shih shembullin 5).

Elementet & gjatësia

Nënfusha nuk ka elemente.

SHEMBUJ

1.

996	□1	df2 \n121231 f019910124 va 3EUR 30,20 900001612 (<i>Monografia mund të huazohet nëse shtypet numri "019910124" ose "00001612".</i>)
-----	----	---

2.

997	01	f200000234 jVit.\5 k1992 mnr.\1-10,12+shtojcë 90002344#1 90002354#3 900024450#4 900024480#5 900024482#6 900024514#9 900024912#12 900024980#shtojcë (<i>Njësia 5 mund të huazohet në bazë të numrit për huazim "00024480" ose me ndihmën e numrit të inventarit dhe numrit të vëllimit "200000234,5". Numrat 2, 7, 8 dhe 10 nuk kanë numra për huazim.</i>)
-----	----	--

3.

997	11	f200000240 jVit.\4 k1991 mnr.\1-5_7+10-12_shtojcë 900013344#1-5_7 900013354#10-12_shtojcë (<i>Numrat e lidhur "1-5_7" mund të huazohen në bazë të numrit për huazim "00013344" ose në bazë të numrit të inventarit dhe numrave të njëjste të lidhura "200000240,1-5_7".</i>)
-----	----	--

4.

997	21	f200000179 jVit.\3 k1990 mnr.\1-7_10-12_shtojcë 900008354 (<i>Komplet viti huazohet në bazë të numrit për huazim "00008354" ose me ndihmën e numrit të inventarit "200000179".</i>)
-----	----	---

5. Regjistrimi para se numrat të lidhen:

997	01	f300000234 jVit.\5 k1992 mnr.\1-10,12+shtojcë 90002344#1 90002354#3 900024450#4 900024480#5 900024482#6 900024514#9 900024912#12 900024980#pril1 (<i>Numri 5 mund të huazohet në bazë të numrit për huazim "00024480" ose në bazë të numrit të inventarit dhe numrit të vëllimit "300000234,5".</i>)
-----	----	--

Regjistrimi pasi që numrat janë lidhur:

997	21	f300000234 jVit.\5 k1992 mnr.\1-10,12_shtojcë 90002344 (<i>Numrat e lidhur mund të huazohen në bazë të numrit për huazim "0002344", e cila para lidhjes i është ndarë vëllimit të palidhur me numër 1, ose në bazë të numrit të inventarit "300000234".</i>)
-----	----	--